



**Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit**

**Nr.07/351/01-10157**

**Dt.20.06.2017**

Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit duke vendosur sipas kërkesës së aplikuesit: **Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim - Komuna Gjakovë**, për dhënien e Lejes së Ndërtimit për ndërtimin e 5 objekteve të banimit individual – shtëpive familjare për familjet e zhvendosura në Mal të ZI të komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptian, me etazhitet P+0, në bazë të Ligjit për Ndërtim, Nr. 04/L-110, nenet 14, 15, 19, 20 dhe 21, si dhe Ligjit për Procedurën Administrative Nr 02/L-28 nenit 11, bien këtë:

## **A K T V E N D I M**

**I. I LEJOHET aplikuesit: Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim në Komunën e Gjakovës, ndërtimi i 5 objekteve të banimit individual – shtëpive familjare për familjet e zhvendosura në Mal të ZI të komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptian**, sipas Projektit Kryesor të prezantuar për 2 tipeve të shtëpive, në përputhshmëri me Planin Rregullativ të Hollësishëm “Kolonia 5”, Kushtet Ndërtimore me nr. 07-351/01-10157, dt.19.06.2017, të lëshuara nga DUMM, në ngastrën kadastrale ndërtimore me nr.5028/1, Z.K. Gjakovë-J-Qytet, në pronësi PSH.KUVENDI I KOMUNËS GJAKOVËS, e cila ka vijën e ndërtimit dhe rregullimit të definuar dhe të prezantuar në planin e situacionit me të gjithë parametrat tjerë përcjellës për ndërtimin e objektit në fjalë, etazhiteti i objekteveit është P+0.

**Tipi 1 = 4 Shtëpi – me Sip (bruto ) të objektit S= 45 m<sup>2</sup> -**

**Tipi 2 = 1 Shtëpi – me Sip (bruto ) të objektit S= 75 m<sup>2</sup>**

**II.** Hartimin e projektit me destinim: ndërtimi i objekteve të banimit individual (Kolonia 5) nga pika 1 e këtij aktvendimi e ka bërë organizata internacionale për migrim “IOM” - Prishtinë.

**IV.** Pjesë përbërëse e këtij aktvendimi është Plan Situacioni i lokacionit me objektin sipas vijës së ndërtimit dhe rregullimit, e përshkruar në situacionin grafik për të cilin është dhënë pëlqimi përkatës nga kjo drejtori i cili është bazë për rilevimin gjeodezik të objektit nga pika 1 e këtij aktvendimi.

**V.** Investitori është i obliguar:

- Që të ruaj një ekzemplar origjinal të dokumentacionit teknik në bazë të cilit i është dhënë kjo Leje Ndërtimi;
- Që pa pëlqimin e hartuesit të projektit kryesor dhe pëlqimin e kësaj Drejtorie, të mos bëjë asnjë ndryshim në projekt;
- Ekzekutimi i punimeve nga pika 1 e këtij Aktvendimi, të realizohet nën mbikëqyrjen e organit mbikëqyrës për realizimin e ndërtimit të objektit.
- Të lajmëroj Drejtorinë e inspektionit për ditën e fillimit të punës së paku 8(tetë) ditë para fillimit të ndërtimit, me qëllim të verifikimit dhe përcjelljes së punimeve:

**VI.** Kjo Leje Ndërtimi vlen 1(një) vit nga dita e lëshimit të këtij aktvendimi.

# Arsyetim

**Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim në Komunën e Gjakovës**, ka parashtruar kërkesën pranë DUMM me nr. 07/351/01-10157 të datës 28.04.2017 për dhënien e Lejes së Ndërtimit për ndërtimin e 5 objekteve të banimit individual – shtëpive familjare për familjet e zhvendosura në Mal të Zi të komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptian, me etazhitet P+0, në ngastrën ndërtimore me nr. 5028/1, Z.K. Gjakovë –J-Qytet, siç është përshkruar në pikën 1 të dispozitivit të këtij aktvendimi.

Së bashku me kërkesën investitori e ka prezantuar edhe këtë dokumentacion:

1. Planin e Situacionit në përpjesë 1:500 të datës 22.02.2017, të vërtetuar nga DUMM - Gjakovë.
2. Kopjen e planit të datës 22.02.2017 (fotokopje) në pronësi të PSH “Kuvendi i Komunës Gjakovë nga Gjakova, lëshuar nga Drejtoria për Kadastër Gjeodezi dhe Pronë.
3. Çertifikata mbi të drejtën në pronën e paluajtshme(fotokopje) me nr. të lëndës zyr-17, të datës 22.02.2017, të lëshuara nga Drejtoria për Kadastër Gjeodezi dhe Pronë.
4. Vendimin nga K.K.Gjakovë, me nr.01 Nr.011-12727, dt.09.02.2015.
5. Vendimin nga K.K.Gjakovë, me nr. 01. Nr. 011-43956/2015, i datës 30.06.2015.
6. Vendimin nga K.K.Gjakovë, me nr. 01Nr. 011-43468/2015, i datës 30.06.2015.
7. Përfundimin nga Bordi i Drejtorëve me Nr. 01 Nr.06-45397-5/1, me datë 10.07.2015.
8. Memorandum i Mirëkuptimit me nr. 01-415-45483, dt.18.10.2016, 0', nr,2144/3 dt.25.10.2016, nr. proces 5, për ‘Eu Kthimi dhe Ri-integrimi në Kosovë faza e IV’(EU-RRK IV) ndërmjet Organizatës Ndërkombëtarepër Migrim (IOM), Ministrisë për Komunitete dhe kthim (MKK) dhe Komunës së Gjakovës.
9. Kushtet Ndërtimore, me nr. 07-351/02-1557, dt.23.03.2017, për rregullimin e hapësirës për ndërtimin e objekteve të banimit individual në ngastrën kadastrale me nr. 5028/1, Z.K: Gjakovë-J-Qytet.
10. Pëlqimin nga KEDS-Gjakovë, së bashku me sqarimet lidhur me lartë përquesi 35 KV, i cili kalon nëpër ngastrën kadastrale me nr. 5028/1, 21.03.2017, dhe të datës 11.08.2015.
11. Pëlqimin nga K.R.U.”Radoniqi”Sh.A.- Gjakovë, të datës 05.08.2015 (të prezentuar më parë).
12. Pëlqimin nga PTK-Gjakovë, të datës 05.08.2015 (të prezentuar më parë).
13. Projektin kryesor në 3 (tri) kopje, organizata internacionale për migrim “IOM” - Prishtinë.

**I liruar nga taksa administrative, në bazë Nenit 5, paragrafi 5.15, nënparagrafi b), të Rregullores për Taksa, Tarifa dhe Ngarkesa nga Shërbimet Komunale, me nr. 01 Nr.011-43964/2015, dt.30.-6.2015.**

## KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij Aktvendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 30 ditësh, duke u llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim. Ankesa i parashtrohet Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor në Prishtinë, dhe e njëjta dorëzohet nëpërmjet kësaj Drejtorie.

### Aktvendimi i dorëzohet:

- Investitorit,
- Drejtorisë së Inspektionit,
- Arkivës.

Zyrtar i Lartë për Çëshjte Juridike

Zenel Shabani, jur.dipl.

U. D. Drejtori

Elida Bejtullahu, inxh.e dipl.e ark.





Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosova  
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor /Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja/Ministry of Environment and Spatial Planning  
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGECIJA KOSOVA / KOSOVA CADASTRAL AGENCY

KOPJA E PLANIT \ KOPIJA PLANA \ COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija \ Municipal Cadastral Office :

GJAKOVË

Zona Kadastrale / Katastarska Zona \ Cadastral Zone : Gjakovë Jashtë Qytet

Njësia \ Jedinica \ Unit	Tipi \ Vrsta \ Type	Sipërfaqja \ Poveršina \ Area m <sup>2</sup>
P - 70705028 - 05028 - 1	Parcelë \ Parcela \ Parcel	7823.0



Shkalla / Razmera /Scale: 1:1000


Punoi \ Obradio \ Created :

Data \ Data \ Date : 28.04.2017

Koha \ Vreme \ Time : 09:53:17

Nënshkrimi \ Potpis \ Siganture:

Shënim \ Beleška \ Note :



Aprovoi \ Usvojio \ Approved : Drejtori \ Direktor \ Director

Nënshkrimi \ Potpis \ Siganture: